



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1330/7 prot

Datë 13.06.2024

V E N D I M

Nr. 677/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.06.2024 me,

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “LASER MED” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-01542-04-16-2024, me objekt: “*Karta, reagente dhe aksesore të tjerë për Lab e Imuno-hematologjisë dhe Bankat e gjakut në Tiranë, përfshirë vënien e pajisjeve në përdorim*” me fond limit 29,988,290 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Kombetare e Transfuzionit të Gjakut.

Autoriteti Kontraktor:

Qendra Kombetare e Transfuzionit të Gjakut
Rr. “Lord Bajron” Laprakë, Tiranë

Ankimues:

Operatori ekonomik “LASER MED” SHPK, me NUIS K12128004G, me adresë: Lagjja Mjull Bathore, Rruga e Elbasanit Nr.4, perballe TEG, Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të*

prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.04.2024 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-01542-04-16-2024, me objekt: “Karta, reagente dhe aksesore të tjerë për Lab e Imuno-hematologjisë dhe Bankat e gjakut në Tiranë, përfshirë vënien e pajisjeve në përdorim” me fond limit 29,988,290 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Kombetare e Transfuzionit te Gjakut.

II.2. Në datën 15.05.2024, operatori ekonomik “Laser Med” SHPK është njoftuar elektronikisht për vlerësimin dhe klasifikimin e ofertave si vijon:

- | | |
|---------------------|-------------------------------|
| 1. “Laser Med” SHPK | 20.224.720 lekë, skualifikuar |
| 2. “Pegasus” SHPK | 24.859.290 lekë, kualifikuar |

Operatori ekonomik “Laser Med” SHPK është skualifikuar për arsyet e mëposhtme:

Arsyet e skualifikimit

Oferta refuzohet pasi rezulton “anomalisht e ulët” bazuar ne ligjin 162/2020” Per prokurimin publik “. Ne ligjin 16/2024 date 08.02.2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin 162/2020” “Per prokurimin publik”, ne nenin 27 te kesaj shtese citohet si me poshte : nenin 93 i LPP pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje: 5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”. Ne kete rast kur jane te vlefshme dy ose me pak oferta ne perputhje me nenin 93 te LPP/162 dhe VKM/285 date 19.05.2021 “per rregullat e prokurimit publik i ndryshuar “ neni 82 pika 4 paragrafi i pare oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur zvogelohet me me shume se 25%te fondit limit te perlllogaritur..”

II.3. Në datën 21.05.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit në SPE.

II.4. Në datën 28.05.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4125 dhe nr. 1330/2024 protokollit, e operatorit ekonomik “LASER MED” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-01542-04-16-2024, me objekt: “Karta, reagente dhe aksesori të tjerë për Lab e Imuno-hematologjisë dhe Bankat e gjakut në Tiranë, përfshirë vënien e pajisjeve në përdorim” me fond limit 29,988,290 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Kombetare e Transfuzionit të Gjakut.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “LASER MED” SHPK.

Konkretisht pretendohet si vijon:

“[...] Referuar ligjit Nr. 162/2020 PER PROKURIMIN PUBLIK, Neni 93, vec pikes 5 te permendur me siper te ligjit 16/2024 date 08.02.2024, citojme me poshte pikat e tjera te ketij ligji: 1. Kur autoritetet ose entet kontraktore verejne se oferta per punet, furnizimet ose sherbimet eshte anomalisht e ulët, i kerkon operatorit ekonomik te paraqese me shkrim dhe brenda tri diteve pune shpjegime per Ámimin ose kostot e propozuara ne oferte 2. Shpjegimet e permendura ne piken 1 jepen veáanerisht per: a) anen ekonomike te procesit te prodhimit, te sherbimeve te ofruara ose te metodës se ndertimit; b) zgjidhjet teknike te perzgjedhura dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem qe ka ofertuesi per furnizimin e produkteve ose sherbimeve ose per kryerjen e punes; c) origjinalitetin e punes, furnizimeve ose sherbimeve te propozuara nga ofertuesi; c) pajtueshmerine me detyrimet qe rrjedhin nga legjislacioni ne fushen e mjedisit, ne fushen sociale dhe te punes; d) mundesine e ofertuesit per te marre ndihme shteterore. 3. Autoriteti ose enti kontraktor vlereson informacionin e dhene, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzoje ofertën kur, edhe pas shqyrtimit te provave te dhena nga ofertuesi, nuk bindet se ajo eshte e rregullt ne te gjitha elementet e saj, duke marre ne

konsiderate elementet e permendura ne piken 2 te ketij neni. Autoritetet ose entet kontraktore e refuzojne oferten kur konstatojne se oferta eshte anomalisht e ulet, sepse nuk pajtohet me detyrimet e zbatueshme nga legjislacioni ne fushen e mjedisit, ne fushen sociale dhe te punes e te akteve te tjera. Pra sic citohet ne pikat e tjera te nenit 93, te ligjit Nr. 162/2020 PER PROKURIMIN PUBLIK, autoritetet kontraktore, ne rastin e ofertave anomalisht te ulta i kerkojne operatorit/operatoreve ekonomik shpjegime per cmimin ose kostot e propozuara, gje e cila ne rastin konkret nuk eshte aplikuar.

Gjithashtu ne VKM Nr.285, date 19.5.2021, neni 82 pika 4, cituar ne arsyet e refuzimit te ofertes nga AK, vec percaktimit te rregullores per ofertat anomalisht te uleta, ne paragrafin e fundit te kesaj pike, cituar ne vijim: nese nje apo disa oferta vleresohen si anomalisht te uleta, komisioni i vleresimit te ofertave duhet te kerkoje sqarime nga ofertuesit, perpara se te marre vendim per kualifikimin ose jo te tyre, ne perputhje me nenin 93, te LPP-se. NE Ádo rast, ofertuesi ka detyrimin te argumentoje dhe te dokumentoje me prova shkresore, sqarimet per elementin/elementet e veáanta te ofertes, ne perputhje me kerkesat e nenit 93, te LPP-se. Percaktohet qarte se Komisioni I Vleresimit te Ofertave DUHET te kerkoje sqarime nga ofertuesit, para se te marre vendim per kualifikimin ose jo te tyre, ne perputhje me nenin 93, te LPP-se, cituar me siper, veprim ky I cili nuk eshte kryer nga Komisioni I Vleresimit te Ofertave. Procesi I kerkeses per sqarime lidhur me ofertat anomalisht te uleta percaktohet edhe ne ligjin Nr. 9643, date 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, date 10.09.2007, Ligjin Nr. 9855, date 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170, date 22.10.2009, Ligjin Nr.10 309, date 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012, Ligjin Nr. 182/2014 dhe Ligjin Nr. 47/2017, Ligjin Nr.103/2018. Neni 56 ku me poshte po citojme piken 1: 1. Kur autoriteti kontraktor veren se nje ose me shume oferta per kontratat e mallrave, puneve apo sherbimeve jane anomalisht te uleta, ai, perpara se te vazhdoje me procesin e vleresimit te ofertave, i kerkon operatorit ekonomik perkates te paraqese me shkrim dhe brenda 3 diteve pune shpjegime per elemente te veáanta te ofertes, per: a) anen ekonomike te metodet se ndertimit, procesit te prodhimit ose te sherbimeve te ofruara; b) zgjidhjet teknike te ofruara dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem, qe ka ofertuesi per kryerjen e punimeve, per furnizimin e mallrave apo te sherbimeve; c) origjinalitetin e puneve, mallrave apo te sherbimeve, te propozuara nga ofertuesi; c) zbatueshmerine e detyrimeve, qe lidhen me mbrojtjen ne pune dhe kushtet e punes, ne vendin ku do te kryhet puna, sherbimi apo ku do te sigurohet furnizimi Gjithashtu, vec legjislacionit te cituar me siper, ne DST e publikuar nga AK, Seksioni 1: udhezime per operatoret ekonomike, Kapitulli F. VLERESIMI I OFERTAVE, pika 22 ivleresimi i ofertave dhe korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht te uletae, nenpika 2, percaktohet nga vete AK veprimet qe duhen ndermarre ne rastin e ofertave anomalisht te uleta, ne vijim citojme kete nenpika: 2. Kur autoritetet /entet kontraktore verejne se oferta eshte anomalisht e ulet, i kerkojne operatorit ekonomik te paraqese brenda tre diteve pune, shpjegime te Ámimit ose kostove te propozuara ne oferte, ne perputhje me nenin 93 te LPP-se dhe vleresojne informacionin e dhene, ne konsultim me ofertuesin dhe ne perputhje me dispozitat e ketij neni. - Ne rast kur jane te vlefshme dy ose me pak oferta, ne perputhje me nenin 93 te LPP-se, oferta konsiderohet anomalisht e ulet kur zvogelohet me shume se 25% te fondit limit te perlllogaritur. - Ne rast kur jane te vlefshme tre ose me shume oferta, ne perputhje me nenin 93 te LPP-se, oferta konsiderohet anomalisht e ulet nese vlere e saj do te jete me pak se 85% e mesatares se ofertave te vlefshme. Nese nje ose disa oferta vleresohen si anomalisht te uleta, Komisioni i

vleresimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, para se të marrë një vendim për kualifikimin e tyre ose jo, në përputhje me nenin 93 të LPP-se. Në Ádo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin / elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-se. I njëjti AK, në vitin 2022, për të njëjtet mallra për procedurën Lot 1 : “Karta, reagente dhe aksesore të tjere për Laboratorin Imuno-hematologjisë në QKTGJ dhe Bankat e gjakut në Tiranë përfshirë venien e pajisjeve në përdorim e Fondi limit lot 1: 59,233,237 (pesëdhjetë e nëntë milion e dyqind e tridhjetë e tre mijë e dyqind e tridhjetë e shtatë) leke pa TVSH ka vendosur që oferta fituese të jetë një ofertë anomalisht e ulët. Ky sipas legjilacionit me siper, në vitin 2022 oferta fituese është me pak se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme Viti 2022 Mesatarja e ofertave (3 oferta): 44,885,026 Lek (85% - 38,152,272.66 Lek) Oferta fituese 30,936,080 lek Bazuar në procedurën me siper të vitit 2022, ofertat anomalisht të ulëta nuk janë dicka e re dhe e panjohur me përpara për këtë procedurë dhe për këtë AK, ndaj paraqitja e ofertës tone në vitin 2024, minimalisht duhet të marrë në konsideratë për kërkesë sqarimesh të metejshme, në të njëjten rrugë që është ndjekur jo me larg se 2 vite përpara. Gjithashtu, lasermed Shpk ka një historik disa vjeçar me AK, Qendra kombëtare e Transfuzionit të Gjaku persa I përket procedurave të realizuara me sukses, pra nuk është një operator i panjohur totalisht, plotëson kriteret e përcaktuara në DST qoftë ekonomik (xhiro, kontrata të ngashme, etj) dhe ato teknike (certifikime ISO, Autorizim nga ministria për tregtim të mallrave, autorizim nga prodhuesi etj). Pra pavarësisht ofertës tone, ekonomikisht me të favorshme (prej rreth 4.6 milion leke me të ulët se oferta fituese) dhe historikut/eksperiencave të mëparshme të kompanisë tone në realizimin e kontratave, AK ka preferuar mos të kërkojë shpjegime/arsye, por ta refuzojë këtë ofertë, ndesh me DST dhe legjislacionet e sipërcituara prej nesh. Si rrjedhojë, në ankime të refuzimit të ofertës tone dhe kërkojmë që AK ta konsiderojë ofertën, pavarësisht vlerës anomalisht të ulët, duke kërkuar sipas legjislacionit dhe përcaktimit në DST, shpjegimet e nevojshme për çartësimin e arsyeve dhe përlllogaritjeve të kësaj ofertë.

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër referencë, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1330/2 datë 29.05.2024, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Laser Med” SHPK.

II.6. Në datat 03.06.2024 dhe 06.06.2024, janë protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1330/3 prot., dhe nr. 1330/4 prot., shkresat e autoritetit kontraktor nr. 75/13 prot., datë 03.06.2024 dhe nr.75/14 prot., datë 04.06.2024. Nëpërmejt këtyre shkresave autoriteti kontraktor informon KPP-së, se ankesa e operatorit ekonomik “Laser Med” SHPK është refuzuar.

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në datën 17.04.2024 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-01542-04-16-2024, me objekt: “*Karta, reagente dhe aksesore të tjerë për Lab e Imuno-hematologjisë dhe Bankat e gjakut në Tiranë, përfshirë vënien e pajisjeve në përdorim*” me fond limit 29,988,290 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Kombetare e Transfuzionit te Gjakut.

III.1.1. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se me datë 02.05.2024 është zhvilluar procedura prokurimit objekt-ankimi.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se me datë 21.05.2024 është publikuar njoftimi i fituesit në SPE.

III.1.3. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 28.05.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4125 dhe nr. 1330/2024 protokoli, e operatorit ekonomik “LASER MED” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.4. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1330/2 date 29.05.2024, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Laser Med” SHPK.

III.1.5. Në datat 03.06.2024 dhe 06.06.2024, janë protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1330/3 prot., dhe nr. 1330/4 prot., shkresat e autoritetit kontraktor nr. 75/13 prot., datë 03.06.2024 dhe nr.75/14 prot., datë 04.06.2024. Nëpërmejt këtyre shkresave autoriteti kontraktor informon KPP-së, se ankesa e operatoriti ekonomik “Laser Med” SHPK është refuzuar.

III.1.6. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen **brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.**

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.1.7. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.

III.1.8. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit.

Në rastin konkret referuar verifikimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe informacionit të dërguar nga ana e autoritetit kontraktor rezultojnë, se njoftimi i fituesit paraprak është publikuar më datë 21.05.2024. KPP vëren, se operatori ekonomik “Laser Med” SHPK, me datë 28.05.2024, ka paraqitur ankesë nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ku kërkon kualifikimin e tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Në rastin konkret referuar dokumentacionit të administruar rezultojnë, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik jashtë afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të **ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit.** Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”

Referuar parashikimeve të sipërcituara, në rastin konkret, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit më datë 21.05.2024 dhe përfundon në ditën e 7-të. Në rastin konkret, afati i fundit për paraqitjen e ankesës në autoritetin ose entin kontraktor, si dhe njëkohësisht në Komisionin e Prokurimit Publik, referuar datës së publikimit të njoftimit të fituesit paraprak, ka qenë data 27.05.2024. Ndërkohë ankesa e paraqitur nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik me datë 28.05.2024, konsiderohet e paraqitur jashtë afateve ligjore të ankimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “ Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji”.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve është i një rëndësie thelbësore, e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Laser Med” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-01542-04-16-2024, me objekt: “Karta, reagente dhe aksesore të tjerë për Lab e Imuno-hematologjisë dhe Bankat e gjakut në Tiranë, përfshirë vënien e pajisjeve në përdorim” me fond limit 29,988,290 lekë pa

TVSH, zhvilluar me datë 02.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Kombetare e Transfuzionit te Gjakut.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifws financiare të paguar nga operatori ekonomik “Laser Med” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri